

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 46/20 Datë: 09.01.2020

Në bazë të nenit 49 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 09.01.2020, merr

V E N D I M

I.

Miratohet Rregullorja për praktikën studentore.

II.

Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.


A r s y e t i m

Senati i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore dhe rregullimit të mënyrës së realizimit të punës praktike të studentëve, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Njësive akademike të UShAF;
3. Arkivit të UShAF;

Rektori
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI





UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Rektori
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 46/20; Datë: 09.01.2020

Ne bazë të nenit 49 pika 1.3 dhe nenit 92 pika 1.4 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) Senati i UShAF-it në mbledhjen e mbajtur me datën 09.01.2020, miraton:

RREGULLORE PËR PRAKTIKËN STUDENTORE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me rregulloren për praktikën studentore në UShAF, (në tekstin e mëposhtëm "Universiteti"), përcaktohen dhe rregullohen çështjet:

- Mënyra e organizimit të punës praktike studentore
- Qëllimi i praktikës studentore
- Puna praktike semestrare
- Vizita praktike studentore
- Mbikqyrësi praktikës studentore
- Përgjegjësia e studentit për praktikën studentore
- Përgjegjësia e Universitet për praktikën studentore
- Përfitimet e studentit nga praktika studentore
- Subjektet potenciale për punë praktike nga studentët
- Mënyra e monitorimit të praktikës studentore
- Format e evidencës për praktikë studentore

Neni 2

Organizimi i punës praktike studentore

Puna praktike e studentëve realizohet në institutet e Universitetit për programet përkatëse, ndërsa një pjesë e madhe e saj realizohet në ndërmarrjet me të cilat universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Studenti në punën praktike, paraprakisht i ka të përcaktuara objektivat e punës të cilat ndërlidhen me kurrikulën mësimore dhe njëkohësisht reflekton në mënyrë aktive në atë çka është duke mësuar. Në vartësi të fushës së studimit përcaktohet edhe lloji i praktikës, mbështetur në programin akademik (syllabus), që monitorohet duke vlerësuar me notë dhe kreditë (ECTS-të) e caktuara.

Neni 3

Qëllimi i praktikës studentore

Qëllimi i kryerjes së punës (mësimi) praktike të studentëve është ndërlidhja e aftësive teorike me aplikim praktik në vend real të punës me çka studentët aftësohen më mirë në profesionin e përzgjedhur.

Neni 4

Praktika semestrale

Praktika semestrale organizohet mbështetur në programin akademik (syllabus), e cila monitorohet nga mësimdhënësi i lëndës dhe eksperti i lëmisë përkatëse nga ndërmarrja, duke u vlerësuar me notë dhe fituar ECTS kreditë.

Neni 5

Vizita praktike

Në vartësi të fushës së studimit dhe lëndës e cila ligjerohet brenda semestrit përcaktohet edhe lloji i praktikës, ky lloj i praktikës mund të jetë vizitë praktike një ditore në kompani, me ç'rast profesori apo eksperti i ndërmarrjes i njofton më për së afërmi studentët për qëllimin e caktuar të vizitës.



Neni 6

Mbikqyrësi i praktikës studentore

Mbikqyrësi i punës praktike të studentëve është mësimpldhënësi i lëndës si dhe eksperti i ndërmarrjes, të cilët bëjnë mbikqyrjen e studentëve dhe proceseve të tjera të cilat ndikojnë në aftësimin e tyre, por edhe në ruajtjen nga fatkeqësitë eventuale të cilat mund të ndodhin si shkak i pakujdesisë apo i mos informacionit të duhur. Mbikqyrja bëhet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së bashkëpunimit e cila lidhet në mes të Universitetit dhe subjektit ekonomik ku kryhet puna praktike.

Rendi shtëpiak ku zhvillohet praktika– studentët duhet të i përmbahen rendit shtëpiak të përcaktuar nga subjekti ekonomik (fabrika), i cili mundëson kryerjen e praktikës.

Neni 7

Mbikqyrjen e punës praktike në institut e bënë mësimpldhënësi i lëndës së bashku me mësimpldhënësin e mësimit praktik dhe laborantit. Disiplina dhe rregullat e punës duhet të përcillen në mënyrë strikte, duke zvogëluar koston, rrezikun dhe humbjen e kohës.

Neni 8

Përgjegjësia e studentit për praktikën studentore

Gjatë ushtrimeve të ndryshme të veprimtarive operacionale për realizim të mësimit praktik, studentët janë të obliguar që përpos sjelljes sipas rregullave, rendit shtëpiak dhe kodit etik, të kujdesen edhe për ruajtjen e makinave, respektivisht aparaturave, në të kundërtën do të pasoj përgjegjësia materiale dhe ajo disiplinore në përputhje me dispozitat e rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale, si dhe ligjeve në fuqi.

Neni 9

Përgjegjësia e Universitetit për praktikën studentore

Universiteti është i obliguar që studentëve t’u mundesoj kryerjen e mësimit praktik të studentëve.



Vend të rëndësishëm zënë siguria e studentëve dhe mbrojtja e tyre nga rreziqet e ndryshme.

Mësimdhënësi i lëndës është personi përgjegjës për pajisjen e studentit me njohuritë mbrojtëse shëndetsore varësisht prej natyrës së punëve që kryen studenti gjatë realizimit të mësimit të punës praktike.

Neni 10

Përfitimet e studentit nga praktika studentore

Nga puna praktike studentët përfitojnë në perfeksionimin e profesionit të tyre, i cili do të shërbejë gjatë gjithë jetës dhe është i bazuar në lidhjen e mësimnxënjes gjatë përcjelljes së leksioneve të cilat më vonë realizohen drejtëpërsëdrejti gjatë kryerjes së punëve praktike.

Neni 11

Subjektet potenciale për punëpraktike nga studentët

Duke pasur parasyshë programet mësimore me të cilat funksionon, Universiteti është i orientuar në lidhjen e marrëveshjeve bashkëpunuese me ndërmarrjet për kryerjen e punëve praktike të studentëve, si në vijim:

- Përpunimi i drurit
- Arkitekturë e interiorit
- Dizajn i mobileve
- Dizajn dhe konstruksione të produkteve nga druri
- Përpunimi mekanik (primar) dhe sekondar
- Dizjani Grafik dhe Multimedia
- Eficiencë të energjisë
- Saldimi
- Financa dhe kontabilitet
- Hotelierike etj.

Neni 12

Mënyra e monitorimit të praktikës studentore

Mënyra e monitorimit të praktikës së punës studentore kryhen në përputhje me nenin 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje. Në raste të veçanta monitorimi për vijueshmëri dhe suksesshmëri mund të bëhet edhe nga persona të tjerë që caktohen me vendim të veçantë nga menaxhmenti i Universitetit.

Neni 13

Format e evidencës për praktikë studentore

Studentët nga Universiteti, sipas rregullores janë te obliguar te përfundojnë një periudhë te caktuar kohore te punës praktike ne kompanitë relevante qe afarojnë në Kosovë, praktika studentore ka për qëllim qe te bëhet ndërlidhja e pjesës teorike te mësimit nga lënda përkatëse me pjesën praktike, ne mënyrë qe studentet te jenë sa me të pregaditur për tregun e punës.

Dokumentacioni i evidencës së realizimit të punës praktike të studentëve është i klasifikuar në dy lloje dhe atë:

Formular për praktikë studentore dhe praktikë semestrale. Në bazë të këtyre formularëve duhet të jenë të përfshira të gjitha të dhënat për subjektin ekonomik (ndërmarrjen), studentin dhe personi përcjellës nga ndërmarrja apo Universiteti.

Neni 14

Dispozitat përfundimtare

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Neni 15

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

Në vijim janë të bashkangjitura shtojca nr. 1, 2 dhe 3 e Rregullores.

Rektori

Prof.Dr. Agron Bajraktari



Shtojca nr.1

Vizitë Praktike

FORMULAR PËR PRAKTIKË STUDENTORE

Emri i organizatës ku kryhet praktika studentore

Adresa e organizatës

Student-i/et nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj , sipas rregullores janë të obliguar të përfundojnë një periudhë të caktuar kohore të punës praktike në kompanitë relevante që afardojnë në Kosovë, praktika studentore ka për qëllim që të bëhet ndërlidhja e pjesës teorike të mësimit nga lënda përkatëse me pjesën praktike, në mënyrë që studentet të jenë sa më të pregaditur për tregun e punës.

Student-i/ët (mund të jenë grup i studenteve):

-
-
-

Lënda: _____

Objektivat e praktikës:

- 1.
- 2.
- 3.

Periudha kohore e praktikës: Date: Prej ---- Deri

Rezultati nga praktika:

a) Shume i mire

kenaqshem d) Mjaftueshëm

b) I mire

e) pamjaftueshem

c) I

Vërejtje apo komente eventuale:

Data:

Mbikëqyrësi:

Profesori ose Zyrtari i Organizatës

Vendi:

Praktika semestrale:

I nderuar pronar i Kompanisë _____,

Faleminderit që keni pranuar studentin e Fakultetit të _____ në programin e studimit _____, që të kryejë pjesën praktike në Kompaninë Tuaj.

Ne së bashku do të bëjmë notimin e studentit _____, andaj, luteni që të jepni mendimin tuaj profesional për sa kohë studenti ka qenë i pranishëm në Kompaninë Tuaj.

1. Vijimi:

Vijimi	Data	Nënshkrimi i kompanisë	Nënshkrimi i studentit
Java I			
Java II			
Java III			
Java IV			
Java V			
Java VI			
Java VII			
Java VIII			
Java IX			
Java X			
Java XI			
Java XII			

1. Interesimi në praktikë:

Shkelqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët

2. Shkathtësitë:

Shkelqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët

3. Sjelljet:

Shkelqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët

Profesori:

Pronari i Kompanisë:

Puna e studentit gjatë hartimit të elaboratit (seminarit):

1. Të dhënat e kompanisë ku keni mbaruar praktikën (jo më shumë se një faqe),
2. Lloji i produktit që është zgjedhur (për çfarë qëllimi përdoret),
3. Vizatimi i produktit dhe renderimi i produktit,
4. Paraqitja e produktit në projeksionet e nevojshme,
5. Paraqitja e prerjeve të nevojshme të produktit,
6. Nxjerrja e detaleve të nevojshme,
7. Vizatimi i skemave të prerjes,
8. Llogaritja e materialit (fleta kreative) duhet përfshihen të gjitha elementet që e përbëjnë produktin,
9. Montimi i produktit,
10. Paketimi i produktit.

Vërejtje apo koment eventual nga Kompania (ndërmarrja):

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të:

UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

dhe

NDËRMARRJËS PËR _____ „XXXX” NË XXXXXXXX

Në shpirtin e zhvillimit të një edukimi universitar sa më të afërt me industrinë, me datën xx/xx/xxxx, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (më poshtë si “Universiteti”), i përfaqësuar nga Rektori Dr. Agron Bajraktari dhe ndërmarrja për _____ “xxxx” (më poshtë si “Ndërmarrja”), përfaqësuar nga z. xxxxxx xxxxxxxx , hynë në një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitutionale.

Qëllimi i marrëveshjes

I.

Qëllimi i kryerjes së mësimit praktik ka të bëjë me lidhshmërinë e mësimnxënies teorike me punë praktike, për arritje më të mëdha dhe avancim të diturisë, të parapara me planet dhe programet mësimore të Fakultetit, por edhe dobiprurëse për një progres më të mirë ekonomik.

Objekti i marrëveshjes

II.

Objekti i marrëveshjes është:

- I. Realizimi i vëzhgimit praktik të studentëve të Universitetit, në Ndërmarrjen e specializuar në fushën e xxxxxxxxxxxxxxxx.
- II. Zhvillimi i temave të diplomës duke ju mundësuar studentëve, krahas udhëheqjes teorike/shkencore, udhëheqjen praktike të punës së diplomës në Ndërmarrje,

III. Angazhimin e Universitetit në zgjidhjen e problemeve praktike/shkencore të Ndërmarrjes.

Mënyra e realizimit të marrëveshjes

III.

Studentët e vitit të I (parë) të II (dytë) dhe III të Universitetit në Ndërmarrje do të kryejnë vëzhgimin praktik një ditë në dy muaj (katër herë gjatë një viti akademik).

Gjatë tërë kohës së kryerjes së mësimit praktik, studentët do të jenë të udhëhequr nga mësimdhënësit e lëndëve adekuate teorike, duke respektuar të gjitha normat dhe dispozitat ligjore të organizatës e cila mundëson aftësimin praktik për studentë.

Studentëve dhe personelit tjetër nuk u lejohet hyrja në reparte pa prezencën e personit që është caktuar nga menaxheri i kompanisë. Studentët dhe personeli janë të obliguar të lëvizin vetëm brenda shiritit kufizues me ngjyrë të verdhë dhe nuk guxojnë ta kalojnë atë. Për këtë duhet të informohen paraprakisht nga udhëheqësi (mësimdhënësi) i studentëve, por do të informohen edhe para vizitës nga personeli i kompanisë (d.m.th për arsye të sigurisë, brenda shiritit të verdhë që kufizon linjën prodhuese, sipas normave ligjore nuk lejohet askush të ketë qasje, me përjashtim të punëtorit përgjegjës të linjës prodhuese). Studentët mund të pyesin personelin mësimdhënës apo përfaqësuesin e kompanisë për atë çka u intereson, por nuk lejohet të marrin ndonjë vetëiniciativë për të prekur qoftë linjën prodhuese apo produktin në proces të prodhimit (duke e kaluar shiritin e verdhë). Për çdo veprim që e kryejnë studentët jo konform udhëzimeve, kompania nuk mban përgjegjësi, por përgjegjësia bie mbi mësimdhënësin apo Universitetin.

IV.

Gjatë vizitës, vëzhgimit praktik apo gjatë përgatitjes së temave të diplomave për secilin individ i cili futet brenda objektit të Kompanisë "xxxxx", përgjegjësia për ndonjë lëndim të mundshëm është individuale. Kompania "xxxxx" nuk mbanë asnjë përgjegjësi, materiale apo penale.

V.

Për probleme të ndryshme praktiko/shkencore, Ndërmarrja mund të angazhojë Universitetin në ofrimin e zgjidhjeve të mundshme aplikative.

Efekti i marrëveshjes

Marrëveshja shtrinë efekt që nga dita e nënshkrimit nga palët dhe do të realizohet përgjatë tërë vitit akademik.

Ndërprerja e marrëveshjes

Kohëzgjatja e marrëveshjes nuk është e limituar, ndërsa mund të shkëputet me paralajmërim prej 30 ditë më parë nga cilado palë nënshkruese .

N Ë N S H K R U E S I T

Rektori

Menaxher Gjeneral

Prof. Dr. Agron Bajraktari

z. XXXXXX XXXXXX

Ferizaj, me: xx.xx.xxxx